



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1955, datë 24.05.2012**

**Për**

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.”,**

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);
- Dokumentet shpresore të palëve (**Provat, Pretendimet**);

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);

2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Rregullore Nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD nr. 1774, datë 02. 02. 2012.
6. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.”,
- Shkresën e Neofone sh.p.k., me nr. 155Prot. datë 3.5.2012 (nr. 509/6Prot i AKEP, datë 7.5.2012) “*Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1878, datë 19.4.2012*”,
- Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 1078Prot., datë 9.5.2012, (nr. 923Prot. i AKEP, datë 10.5.2012), ka sjellë “Pretendimet me shkrim të shoqërisë EM, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit me Neofone”, si edhe,
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N :**

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
  - “Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.;
  - Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
  - Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;
- II. Neofone sh.p.k., me shkresën nr. 155Prot., datë 3.5.2012, “*Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1878, datë 19.4.2012*” sqaron se:

1. Eagle Mobile me shkresat nr. 65 Prot. datë 11.01.2012 dhe nr. 228 Prot. datë 19.1.2012, njofton Neofone “Aplikimin e tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtar duke filluar nga data 01.02.2012”. Neofone sh.p.k. pretendon se në këtë njoftim Eagle Mobile ka kërkuar në mënyrë të njëanshme ndryshimin e tarifës së interkoneksionit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare.

Neofone sh.p.k, ka dërguar përgjigje me shkresën nr. 122Prot. datë 17.01.2012, ku i kërkon të ketë zhvillim negociatash dy palëshe në zbatim të kuadrit rregullatorë.

Eagle Mobile, ka konfirmuar me anë të postës elektronike, takimin më datë 23 janar ora 11:00, të mbajtur në ambientet e EM. Në këtë takim, nuk u ra dakord për tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare në rrjetin Eagle Mobile. Ky i fundit nuk pranon të rinegociojë tarifën e njoftuar nëpërmjet shkresës me nr. 228 Prot. datë 19.01.2012.

2. Neofone sh.p.k. nuk ka fimosur Amendamentin e Marrëveshjes së Interkoneksionit, pasi tarifata e paraqitura nga EM ishte 21 Lek/min, vlerë e cila është dyfishi më e lartë se ajo pararendëse që ishte 8.85 Lek/min dhe gati katërfishi i kostos reale të EM përcaktuar nga metodologjia BULRAIC.

Neofone sh.p.k ka dërguar shkresën me nr. 125 Prot.datë 24.01.2012, në këtë shkresë Neofone e fton përsëri në një raund të dytë negociatash operatorin FNT EM, në zbatim të kuadrit rregullator, ku rishprehet dhe mosdarkortësinë me tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare 21 Lekë/min. Eagle Mobile nuk kthen përgjigje.

3. Më datë 8 shkurt 2012, operatori FNT - EM pa njoftuar në mënyrë të njëanëshme ka anuluar kapacitetin minimal 2 Mbps në shërbim të Neofone për disa orë. Neofone sh.p.k. ka njoftuar për ndërprerjen nëpërmjet postës operatorin EM. Në përgjigje të njoftimit të Neofone, operatori EM, ka mohuar faktin duke e rialokuar përsëri kapacitetin e bllokuar dhe ka ftuar Neofone në një takim urgjent po atë ditë. Ky takim i mbajtur në datë 08.02.2012 ora 14:00 nuk ka dhënë asnjë rezultat.

Më datë 16 Shkurt 2012 operatori EM Sh.a ka marrë masë ekstreme të anulimit të ‘faciliteteve shoqëruese’ dhe ndërprerjen e shërbimeve të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare për operatorin Neofone Sh.p.k. Neofone Sh.p.k më datë 16 shkurt 2012 ka njoftuar operatorin FNT EM për shkeljen e “faciliteteve shoqëruese” dhe ndërprerjen e aksesit dhe interkoneksionit për shërbimet e përfshira në MI midis palëve. Neofone Sh.p.k më shkresën nr. 134 Prot. datë 20.02.2012, “Për anulimin e faciliteteve shoqëruese të alokuara për Neofone Sh.p.k dhe ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve me origjinë rrjetet ndërkombëtare” ai i ka kërkuar operatorit FNT EM të rihapë qarqet e bllokuara dhe ndalimin e shkeljeve në dëm të operatorit Neofone. Operatori EM nuk i përgjigjet përsëri shkresës së Neofone nr. 134 Prot., datë 20.02.2012.

4. Neofone sh.p.k. ka dërguar shkresën nr. 137 Prot., datë 23.02.2012, ‘Për mosterminimin e thirrjeve të portuara nga rrjetet e tjera mobile në rrjetin Eagle Mobile me origjinë rrjetet ndërkombëtare’. Operatori EM nuk i përgjigjet përsëri shkresës së Neofone nr. prot 137 datë 23.02.2012.

Neofone Sh.p.k. ka dërguar shkresën nr.. 145 Prot. datë 12.03.2012, “Për moshapjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga shërbimi me kartë të parapaguara (OSHKP) dhe anulimin e faciliteteve shoqëruese të alokuara për Neofone Sh.p.k”. Nga gjithë korrespondenca e drejtuar me EM nuk ka pasur anjë reagim nga operatori EM, duke injoruar plotësisht çdo praktikë ligjore.

Aktualisht operatori EM vazhdon të mbajë të mbyllur qarqet e interkoneksionit me kapacitet minimal 2 Mbps për Neofone duke lënë vetëm 15 kanale të ahpara për shërbimin e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe asnjë kanal të hapur për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga rrjetet ndërkombëtare.

5. Neofone, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9918, operaon si tranzitues dhe bartës i trafikut me origjinë ndërkombëtare dhe si operator i licensuar për telefoni fikse. Neofone bashkëpunon me palë të treta duke u ofruar mundësimin e terminimit të trafikut të tyre në rrjetin e EM, si dhe përmbush misionin e krijimit të konkurrencës efektive në tregun shqiptar për shërbimin e terminimit, në të cilin EM është OFNT. Sjellja e EM, duke bllokuar aksesin dhe interkoneksionin në qarkun E1 në mënyrë të njëanshme, është në kundërshtim me parimet e konkurrencës së ndershme të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke shfrytëzuar pozitën me FNT. Kjo bëhet me qëllim tkurrjen e tregut të lirë të konkurrencës duke zbatuar politika të diskriminimit dhe abuzimit me pozitën FNT.

Neofone është detyruar të vuajë financiarisht mbylljen e qarqeve të interkoneksionit nga EM, si dhe kosto të tjera si prishja e imazhit dhe kontratave komerciale me operatorë jashtë vendit.

Në kushtet kur konsensusi për tarifën nuk është në vullnet të lirë të të palëve dhe operatori FNT mbyll aksesin dhe interkoneksionin dhe vendos një tarifë jo të orientuar në kosto (ose nuk provon të kundërtën) palët i drejtohen AKEP.

6. Neofone, shpjegon se operatori FNT Eagle Mobile ka kryer disa shkelje në mënyrë të njëpasnjëshme:
  - a.Referuar Ligjit 9918, “Për komunikimin elektronik dhe postar në Republikën e Shqipërisë”: neni 42, Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorim i përbashkët i faciliteteve të rrjetit; Neni 59, Zbatimi i detyrimit për orientimin e tarifave drejt koston;
  - b.Referuar MI të lidhur mes Eagle Mobile sh.a. dhe Neofone sh.p.k., datë 5.10.2011: Aneksi 4 – pika 4.6.2 Kapaciteti minimal për qarqet dhe linket e interkoneksionit për çdo pikë interkoneksioni është 2Mbps apo 1 x E1, Pikën 7.1, Pikën 18.4 ;
  - c. Referuar Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë ( Pjesa IV): Neni 420, Neni 663, Neni 673, Neni 681, Neni 682, Neni 685, Neni 690, Neni 693, Neni 707.

7. Neofone nuk e ka pranuar çmimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Eagle Mobile sh.a., për shkak se është :
  - Cmimi nuk është i orientuar drejt koston, madje e tejkalon koston disa herë, duke krijuar një përçindje disa herë fitimi, si dhe duke krijuar një monopol të Eagle;
  - Diskriminon llojin e trafikut në lidhje me origjinën kombëtare/ndërkombëtare;
  - Është tarifë më e lartë se kufiri maksimal i tarifave të rregulluara nga AKEP;

- Është disa herë më e lartë se cmimet mesatare të zbatuara në BE;
- Është cmim abuzues, shpërdorues dhe antikonkurrues, pasi është mjaftueshëm i lartë për të nxjerrë nga tregu operatorët e tjerë.

8. Sipërmarrësi Neofone sh.p.k., i kërkon AKEP, që në zbatim të ligjit nr. 9918, nenet 7,8, 61, 120:

Të urdhërojë urgjentësisht hapjen e aksesit për Neofone sh.p.k. nga Eagle Mobile sh.a., dhe detyrimin për zbatimin e ligjit dhe mosrestriktim të kanaleve si për trafikun kombëtar dhe për atë ndërkombëtar duke kryer procedimin administrativ brenda afatit minimal 30 ditor.

Përcaktimin e tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Eagle Mobile, në përmbushje të ligjit nr. 9918, “Për komunikimet elektronike në R.SH.”

II. Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 1078Prot., datë 9.5.2012, (nr. 923Prot. i AKEP, datë 10.5.2012), ka sjellë “Pretendimet me shkrim të shoqërisë EM, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit me Neofone”. Bëjmë me dije se, këto pretendime të Eagle Mobile sh.a., janë sjellë jashtë afatit prej 15 ditësh sipas pikës 4, të Vendimit nr. nr. 1878, datë 19.4.2012. Me këtë shkresë

Eagle Mobile sqaron se:

1. Ka lidhur MI me Neofone me datë 5.10.2011, dhe në zbatim të VKD 1741, datë 20.12.2011, Eagle Mobile njoftoi të gjithë operatorët për shfuqizimin e detyrimeve për tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duke filluar nga dt. 1.2.2012.
2. Me shkresat me nr. 65Prot., datë 11.1.2012 dhe nr. 228Prot., datë 19.12.2012, ka njoftuar Neofone për tarifën e re, duke i dërguar dhe amendamentin e MI. Neofone ka pretenduar se EM ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme tarifën e terminimit në EM prej 21 lekë/min. EM ka sqaruar se këtë tarifë u ka ofruar dhe operatorëve të tjerë me të cilët ka MI dhe se ka vepruar në përputhje me kuadrin rregullator. Pretendimi i Neofone për tarifë të njëjtë si për terminimin e thirrjeve kombëtare me atë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është në kundërshtim me VKD nr. 1741, dhe diskriminuese ndaj operatorëve të tjerë të cilët kanë pranuar dhe nenshkuar amendamentet e MI me tarifën e re.
3. Gjithashtu, EM ka sqaruar se VKD nr. 1933, datë 7.5.2012, “Disa korrigjime në VKD nr. 1885, datë 19. 04. 2012 të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.A.””, shprehet se: *Tarifën e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfites drejt abonenteve të rrjetit të Eagle Mobile (102), Eagle Mobile ka të drejtë ta ndryshojë duke njoftuar për këtë me pare me shkrim Operatorin Perfites.*
4. Neofone ngre padrejtësisht pretendime si anulimi i kapacitetit minimal 2 Mbps, anulimin e faciliteteve shoqëruese, mosterminimin e thirrjeve të portuara nga rrjetet e tjera mobile në rrjetin e EM me origjinë rrjetet ndërkombëtare etj. Në takimin e dt. 8.2.2012, EM ka sqaruar se nuk ka patur ndërprerje të interkoneksionit e trafikut dhe

- se nga monitorimi ka rezultuar se Neofone ka dërguar një sasi të konsiderueshme të trafikut ndërkombëtar që tejkalon parashikimin e garancisë financiare.
5. Pretendimet e Neofone për terminimin e trafikut ndërkombëtar në rrjetin e EM me një tarifë të ndryshme nga tarifa që paguan cdo operator, si dhe për bllokimin e aksesit dhe interkoneksionit, janë të pabazuara si në kuadrin rregullator ashtu edhe në fakte.

Sa me sipër, në zbatim të ligjit nr. 9918, Eagle Mobile sh.a., kërkon rrëzimin e pretendimeve të Neofone sh.p.k., si të pabazuara në prova e në fakte dhe në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, si edhe mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1878, datë 19.4.2012.

### III. AKEP pasi ka shqyrtuar pretendimet e paleve vëren dhe vlerëson se,

1. Sipas pikës 1.a) të nenit 13 të ligjit nr. 9918, ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet kundrejt autorizimit nga AKEP-i, me përjashtim të rasteve kur rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike:
  - a) nuk kanë qëllime fitimi (tregtimi) dhe kur nuk janë të disponueshme për publikun.

Në zbatim të këtij kushti ligjor dhe kompetencës së parashikuar në shkronjën p) të nenit 8 të po këtij ligji, AKEP-i në Rregullore Nr. 24, datë 02.02.2012, “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD nr. 1774, datë 02.02.2012, në procedurën e aplikimit të regjistrimit të njoftimit përcakton se kur një sipërmarrës dëshiron të ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, ai autorizohet nga AKEP nëpërmjet lëshimit të Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit, pasi të ketë plotësuar kushtet:

- të jetë një operator aktiv që ofron rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike;
- të jetë pajisur nga AKEP-i me ISPC sipas rregullave të përcaktuara në Aktin Nr. 17, datë 16.04.2010 “Rregulla për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.

Gjithashtu, sipas nenit 13 të Rregullores nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, përcaktohet se: *“Të gjitha konfirmimet e njoftimit të lëshuara sipas rregullores Nr. 3, datë 19. 09. 2008, mbeten në fuqi dhe veprojnë deri në çastin e ndryshimit të tyre në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore por jo më vonë se 3 muaj nga data e miratimit të saj”*. Kjo do të thotë që brenda këtij afati ligjor (deri më datë 08.05. 2012), të gjithë sipërmarrësit e interesuar duhet të aplikojnë dhe të pajisen me Çertifikatën e Njoftimit të Konfirmimit sipas Rregullores së re Nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”. Pas këtij afati, asnjë sipërmarrës nuk është i autorizuar të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike nëse nuk është pajisur më parë nga AKEP-i me Çertifikatën e Regjistrimit të Njoftimit për ofrimin e tyre.

Sipas këtyre kushteve ligjore dhe rregullatore, ankimesi nuk mund të ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, pasi në përfundim të afatit tranzitor sipas nenit 13 të Rregullores nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” deri në datën e

shqyrtimit të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas këtij vendimi, nuk është i autorizuar ta ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, sepse gjendet në kushtet e mosplotësimit të kushteve sipas Aktit Nr. 17, datë 16. 04. 2010 “Rregulla për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.

2. Për sa i përket periudhës nga data e pranimit të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe fillimit të procedimit administrativ sipas VKD nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.”., bazuar në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga palët duke iu referuar bazës ligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi në atë periudhë, mosmarrëveshja duhet të çmohet duke marrë në konsideratë se AKEP me VKD nr.1741, datë 20.12.2011, ka vendosur që tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranziturara të jetë jashtë rregullimit duke filluar nga data 1.02.2012. Njëkohësisht AKEP me VKD nr. 1885, datë 19.04.2012 ka miratuar edhe shtesat dhe ndryshimet përkatëse të RIO së Eagle Mobile, ku janë materializuar vendimet e AKEP-it për këtë çështje. Në këto kushte palët për nivelin e tarifës (çmimin) për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara duhet të bien dakort midis tyre mbi bazën e negociatave në kushtet e lirisë kontraktuale për vendosjen e një çmimi në përputhje me interesat reciproke komerciale. Sipas këtij kushti sipërmarrësi Eagle Mobile ka lidhur marrëveshjet e interkoneksionit dhe me sipërmarrësit e tjerë të interesuar. Duke iu referuar fakteve të paraqitura nuk rezulton që Eagle Mobile të mos ia ketë ofruar Neofon-it të njejtën tarifë që ka lidhur edhe me sipërmarrësit e tjerë për këtë shërbim. Ka qenë Neofone ajo që nuk e ka pranuar këtë tarifë të Eagle Mobile, duke mos marrë në konsideratë faktin që tashmë kjo tarifë është jashtë rregullimit nga AKEP-i.

3. Pretendimet e Neofone për interkonektimin me Eagle Mobile kanë lidhje me shërbimin e Nefone të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për terminim në rrjetin Eagle Mobile dhe jo për shërbimin publik telefonik fiks të ofruar pajtimtarëve të rrjetit publik fiks Neofone. Neofone ka deklaruar se nuk ka pajtimtarë telefonik fiks për 2010 dhe 2011, duke ofruar vetëm tranzitim thirrjesh.

4. Nga sa faktohet më sipër, në interpretim të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 9918, duke qenë se Neofone sh.p.k., në momentin e shqyrtimit të këtij vendimi nuk është i autorizuar nga AKEP-i sipas legjislacionit dhe kuadrit rregullator në fuqi për ofrimin e shërbimit të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, për rrjedhojë nuk gjendet në rrethanat e plotësimit të kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 9918 për vendosjen ndaj Eagle Mobile të detyrimit me anë të një Urdhëri për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e terminimit në rrjetin e Eagle Mobile të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara prej tij.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## **V E N D O S:**

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.”.
2. Të mos pranojë kërkesën e Neofone sh.p.k., për nxjerrjen e një Urdhëri për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me sipërmarrësin Eagle Mobile Sh.a., për shërbimin e terminimit në rrjetin e Eagle Mobile të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara prej tij.
3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a., për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. Alban **KARAPICI**
2. Alketa **MUKAVELATI**
3. Benon **PALOKA**
4. Zamira **NURÇE**